BalkanWeb | GAZETA SHQIPTARE

Fillimi > -Kronikë

Ekzekutimi i biznesmenit në Shëngjin/ Nga makina e blinduar tek precedentët e mëparshëm penalë, “Në Shënjestër” zbardh detajet e reja

19 Prill, 2023 20:37

Madhësia e tekstit: ⊖ ⊕

Ditën e sotme një ngjare e rëndë ka ndodhur Shëngjinit, ku është ekzekutuar me armë zjarri Ardian Nikulaj. Biznesmeni 50 vjeçar kandidatonte në zgjedhjet e 14-majit për anëtar të Këshillit Bashkiak në qytetin e Lezhës, në siglën e PSD.

Emisioni “Në Shënjestër” ka zbardhur detaje të reja lidhur të shkuarën e viktimës si dhe për autorin, i cili mendohet të ketë udhëtuar me një motoçikletë deri në lokalin e viktimës, ku dhe e qëlloi për vdekje.

Nikulaj ishte pronar i disa bizneseve në zonën e Lezhës dhe të Shëngjinit, midis tyre edhe i lokalit ‘Koral’, pranë portit të qytetit. Aty ku u qëllua edhe mesditën e sotme, në orën 13.30, nga një person i maskuar, i cili siç shikohet edhe në këtë foto, të momentit të ekzekutimit, hyri në lokal, i veshur me uniformë shërbimi ngjyrë blu dhe mbi të, mbathur një jelek fosforishent.

Me shumë gjasa, një kamuflim, si ato që përdoren nga motoristët që shërbejnë në delivery, apo shërbimet me porosi. Person i cili sipas policisë, qëlloi 6 herë mbi Nikulaj, me pistoletën TT të drejtuar nga tavolina ku ai qëndronte, ku 2 nga plumbat thuhet se rezultuan fatal për jetën e tij dhe e qëlluan viktimën në prani të kamarierit dhe të një roje sigurie, por edhe të vjehrrit të tij, i cili pa i tronditur të gjithë skenën e krimit.

Sipas dinamikës paraprake të ndërtuar nga grupi hetues, autori që qëlloi mbi biznesmenin, thuhet të ketë mbërritur në lokalin e Nikulaj, nga qyteti i Shkodrës.

GET IT ON Google Play

Kerko ketu

LAJMET E FUNDIT

Rënia e çmimit të materialit ndërtues, në Maqedoninë e Veriut pritet të ulet edhe çmimi i apartamenteve

19 Prill, 2023

“Pendohem që u rifuta”, Kiara pas debatit me Efin: E vuaj raportin me të

19 Prill, 2023



Atentati ndaj ish-prokurorit Arjan Ndoj, arrestohet nipi i deputetit socialist, Ramazan Rraja

19 Prill, 2023

E rëndë në Maqedoninë e Veriut, emigranti tenton t’i marrë armën policit dhe të largohet, por goditet për vdekje

19 Prill, 2023

Vrasja e biznesmenit Bledar Birçajt në Vlorë/ Ferhati: Gjeneza vjen nga jashtë shtetit. Daci: Zbardhja e ngjarjes është e vështirë, s’kemi evidenca

19 Prill, 2023



Iu kthye e gjithë shtëpia kundër, Efi: Dhjetë veta bashkë ju përballoj

19 Prill, 2023

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE

@balkanweb

Ai mendohet të ketë udhëtuar aty me një motoçikletë dhe të ketë qenë i vetëm. Sipas skemës së ndërtuar të ngjarjes, ai ka hyrë nga një derë anësore e lokalit dhe pasi ka kryer krimin, është larguar nga një derë e dytë e restorantit, po me mjetin motoçikletë me të cilin mbërriti, çka rrit dyshimet te policia se ai veproi i vetëm.

Në momentin e vrasjes, sipas të dhënave, ndodhej edhe një nga bashkëshortet e Nikulaj, e cila në momentin e ekzekutimit ishte në kuzhinë, ku edhe punonte.

Kjo pasi viktima ishte i martuar dy herë dhe nga këto martesa kishte katër fëmijë, dy vajza dhe dy djem, ndërkohë që të pranishmit në skenën e krimit, menduan fillimisht se personi që hyri në lokal, për nga veshja, ishte një postier.

Por kush ishte Ardian Nikulaj dhe a ka lidhja vrasja e tij me fushatën e fundit zgjedhore, ku ishte kandidat për anëtar të Këshillit Bashkiak në Lezhë?
Sipas të dhënave që ka mundur të sigurojë emisioni 'Në shënjestër', Nikulaj kishte qenë edhe më herët i përfshirë në fushatë, ai ishte kreu i Partisë Social Demokrate në Lezhë. Parti e drejtuar nga ish-deputeti Tom Doshi.

Në vitin 2021, Nikulaj, kandidoi si deputet në siglën e PSD, për qarkun Lezhë, por pa mundur të fitojë, ndërsa në këto zgjedhje ai kandidonte për anëtar të Këshillit Bashkiak në qytetin e Lezhës, po në siglën e PSD.

Ardian Nikulaj mësohet se kohët e fundit qarkullonte me makinë të blinduar, pasi ishte kthyer nga emigracioni ku kishte jetuar për një kohë të gjatë, ai kishte nisur investimin në zonën e Lezhës, kryesisht në ndërtim dhe biznese të tjera.

Ai figuronte më herët i arrestuar për disa vepra penale, më konkretisht në vitin 2003 ai mësohet se ishte dënuar me katër muaj heqje lirie për armëmbajtje pa leje, kurse në vitin 2006 me gjobë për kontrabandë dhe falsifikim dokumentesh. Sikurse ishte i njohur si biznesmen dhe për lidhjet e tij me politikën lokale, biznesmeni tashmë i ekzekutuar njihej edhe për lidhjet e tij me krimin.

Ai thuhet se ka shërbyer si ndërmjetës për shuarjen e një konflikti midis ish-deputetit socialist Arben Ndoka dhe Aleksandër Dedës, personazhit të njohur si Leksi i Druve. Pajtim që sipas rregullave u bë në kishë, ku palët u betuan që nuk do kishin më konflikte me njëri-tjetrin.

Ndërkohë Ardian Nikulaj, njihej edhe për miqësinë e tij me të tjerë emra të botës së krimit, por edhe pse për grupin hetues është shumë herët për të dalë në një përfundim se cila është pista e vrasjes së biznesmenit 50 vjeçar, ato duket se do të ndalen te aktiviteti i tij kontrovers, midis biznesit, politikës dhe lidhjes me personazhe të botës së krimit,

Sipas të dhënave që disponon emisioni 'Në Shënjestër' një tjetër pistë e qëndrueshme është ajo e një konflikti të mbartur në kohë.

Në vitin 2010, Ardian Nikulaj, ka humbur një vëlla, i cili thuhet se u ekzekutua nga fisi Palaj, që ishte në një konflikt të hapur gjakmarrje me atë Nikulaj. Gjakmarrje e cila vazhdoi edhe më tej në kohë, ku fisi Palaj humbi dy pjesëtarë të tij, edhe pse këto vrasje thuhet se nuk u zbardhën kurrë.

Por edhe pse ishte kreu i PSD në Lezhë, parti e lidhur me të majtën dhe vetë kandidonte për këtë sigël si këshilltar bashkiak në këtë qytet, ai thuhet se mbështeste kandidatin e koalicionit 'Bashkë fitojmë' të drejtuar nga Meta dhe Berisha, për bashkinë e Lezhës, Pashk Gjoni.

BalkanWeb

Për t'u bërë pjesë e grupit "**Balkanweb**" mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

Etiketa: Ardian Nikulaj

TË NGJASHME

Nga dyshimet për hakmarrje tek dëshmia e familjarëve, si ndodhi ekzekutimi i biznesmenit Ardian Nikulaj në Shëngjin. Autori u largua në drejtim të Shkodrës dhe ...

19 Prill, 2023

Tre të vrarë në pak vite nga dy fise/ Dyshohej se biznesmeni i ekzekutuar në Shëngjin kishte konflikte me familjen Palaj, policia nis kontrollet. Ja çfarë u zbulua

19 Prill, 2023

Taboola Feed

If you have nail fungus, do this immediately

Eelhoe | Sponsored

Get Offer

If you own a mouse, you will never turn off your computer again.

PanzerRush | Sponsored

Zbulohen kontratat e Big Brother Vip, ja kush është banorja më e paguar

Zbulohen kontratat e Big Brother Vip, ja kush është banorja më e paguar

balkanweb.com

Unsold Alaska Senior Cruise Cabins (Take A Look At The Prices)

Cruise Vacation Offers | Sponsored

Search Now

TË FUNDIT NGA -KRONIKË



Atentati ndaj ish-prokurorit Arjan Ndoj, arrestohet nipi i deputetit socialist, Ramazan Rraja

19 Prill, 2023

Vrasja e biznesmenit Bledar Birçajt në Vlorë/ Ferhati: Gjeneza vjen nga jashtë shtetit. Daci: Zbardhja e ngjarjes është e vështirë, s'kemi evidenca

19 Prill, 2023

Konfiskimi i "Prestige Resort", flet për Panorama TV drejtoresha e Komitetit të Helsinkit: VKM e qeverisë në kundërshtim me kodin penal, asnjë garanci për subjektet

19 Prill, 2023

Vrasja e Bledar Birçajt në Vlorë/ Nga dëshmia e të dashurës tek pistat e hetimit, kush e ekzekutoi biznesmenin?

19 Prill, 2023

"Kishte marrë kërcënime nga..."/ Vrasja e biznesmenit në Lezhë, reagon Berisha: Ndodhi tre ditë pasi viktima doli kundër Pjerin Ndreut

19 Prill, 2023

Vrasja e biznesmenit në Lezhë/ Daci: Kishte ndikim në politikë, mund të përcaktonte se kush do fitonte 'lokalet'. Ferhati: Atentatori s'ka pasur konflikt me...

19 Prill, 2023

KATEGORIA VIDEO

Vrasja e Bledar Birçajt në Vlorë/ Nga dëshmia e të dashurës tek pistat e hetimit, kush e ekzekutoi biznesmenin?

19 Prill, 2023

Atentati ndaj biznesmenit vlonjat/ "Në Shënjestër" zbulon detajet, si u ekzekutua Birçaj dhe kush e shoqëronte në makinë

19 Prill, 2023

Finalja e Kampionatit Europian të mundjes, Abakarov i jep medalje argjendi Shqipërisë (VIDEO)

Çfarë ishte... spiralja misterioze që u shfaq në qiellin e Alaskës natën e të "Shtunës së Madhe"?

19 Prill, 2023

Nga dyshimet për hakmarrje tek dëshmia e familjarëve, si ndodhi ekzekutimi i biznesmenit Ardian Nikulaj në Shëngjin. Autori u largua në drejtim të Shkodrës dhe ...

19 Prill, 2023

19 Prill, 2023

Gara për 14 majin/ "Mazhoranca punon për të deformuar e manipuluar votën", Lubonja: Rama fryn figurën me posterat, kthim mbrapa

19 Prill, 2023

BalkanWeb

FAQET ZYRTARE

TV News24 Live
News24.al
Radio RASH

PRIVATËSIA

POLITIKA E PRIVATËSISË

KONTAKT

redaksia@balkanweb.com

EMISIONE NEWS24

Alert
Autoktonët
Dola te Ola
Emisioni Vila 24
Fit Station
Frontline
Jeta_pa_filtër
Kjo Javë
Klinika 24
Koha për t'u zgjuar
Me zemër të hapur
Në mëngjes me Klarkun
Në shënjester
Open
Pikat mbi i
Sport News
Sport News Plus

KATEGORI

Fillimi
Shqipëria
Kosova
Rajoni
Sport
Bota
Kulturë
Metropol
Analiza
Teknologji

MEDIAT E HUAJA

New York Times
Guardian
WEB BBC
WEB CNN
REUTERS
Washington Post
Times Online
Financial Times
WEB Yahoo
WEB MSN
USA Today

© 2023 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.